



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947

KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

Nr. repertori: 3074

Nr. koleksioni: 1386

Tirane më 16/12/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2024053010131186106



A2024053010131186106

AKT THEMELIMI

Sot, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

THEMELUES/IT:

Vangjel Deme, atësia Xhemal, amësia Kadime, shtetas Shqiptar, lindur në Vloçisht, Korçë dhe banues në TIRANË, me adresë Dhokë Orgocka; Nd. 55; H. 1; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1005; Tiranë, lindur më 31/01/1965, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039572644 dhe nr. personal G50131085M, .

I cili ka vendosur të themelojë shoqërinë tregtare “Albanian Metal Exchange” shpk, me kushtet si më poshtë:

NENI 1

STATUSI JURIDIK

Shoqëria Tregtare “Albanian Metal Exchange” Sh.p.k është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Albanian Metal Exchange” Sh.p.k.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Nxjerrje, perpunim, pasurim, tregetim me shumice dhe pakice. import-eksport i të gjithë llojeve të mineraleve (si baker, krom, hekur, nikel, zink, qymyrguri, etj. xeherore dhe jo xeherore) - dhe të nenprodukteve të tyre dhe metaleve të ndryshme.
- Nxjerrje, perpunim, prerje , tregetim me shumice e pakice, import-export, e të gjithë llojeve të gureve (si gur, mermer, granit, etj.) , deri në pergatitjen dhe ofrimin e produktit të gatshëm.
- Shkëmbim metalesh dhe ankand metalesh.
- Financim, pergatitje, zbatim dhe konsulence në fushën inxhinierike, minerare dhe të ndërtimit.
- Tregetim me shumice dhe pakice, për import dhe eksport i mallrave të ndryshëm tekstilë dhe industriale.
- Financime në fusha të ndryshme.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: “Bulevardi Dëshmoret e Kombit 9, Tiranë 10 10, Hotel Rogner”, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 000 (njëqind mijë) leke, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Z. **Vangjel Deme** zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakut themelues Z. **Vangjel Deme**.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË



A2024053010131186106

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7

ORGANET DREJTUESE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;

2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “Albanian Metal Exchange” Sh.p.k, është Z. **Vangjel Deme**, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara cdo organi administrativ, gjyqësor, apo cdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8

LIGJI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues. Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUESI

Vangjel Deme

Vangjel Deme

